



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 977 prot.

Tiranë, më 23.07.2024

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 06, datë 23.07.2024

PËR

**PËR HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE EFEKTIVE TË VEPRAVE PENALE
KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE**

Në mbështetje të nenit 148 shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38, pika 2, shkronjat "b" e "dh" dhe nenit 46, pika 3, shkronja "c" të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Kodit Penal, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar transnacional, e ratifikuar me ligjin nr.8920/2002 dhe Protokollit shtesë të saj "Mbi parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve" (Protokolli i Palermos), dhe Konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore" (Konventa e Varshavës), e ratifikuar me ligjin nr.9642/2006,

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim unifikimin e masave administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive të krimeve të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve, në afate optimale (shpejta), mbrojtjen eficiente të të drejtave të viktimate të

trafikimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe paraqitjen e kërkuesave për masa dënim i efektive, proporcionale e frenuese, që të kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të trafikimit.

2. Ky udhëzim ka për qëllim gjithashtu, plotësimin e kuadrit nënligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktimen e trafikimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në vijim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.5/2018 “*Për garantimin e asistencës ndaj viktimateve dhe dëshmitarëve të veprave penale*” në fuqi, në veprimtarinë e prokurorive me juridiktion të përgjithshëm.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

- a) Përcaktimi i masave administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiktion të përgjithshëm, lidhur me rritjen e eficiencën në luftën kundër kriminalitetit në fushën e trafikimit të personave, ndërmjet prokurorit me drejtuesin e seksionit, drejtuesin e prokurorisë dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë, si dhe të strukturave të posaçme të shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit.
- b) Zbatimin e një politike penale¹ ndëshkuese më efektive dhe proporcionale ndaj trafikantëve të personave, me qëllim parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të gjitha formave të trafikimit të personave.
- c) Rritjen e numrit të hetimeve pro-aktive në çështjet e trafikimit të personave, përfshirë dhe hetimet financiare dhe ato për pastrimin e parave.
- d) Rritjen e bashkëpunimit të brendshëm ndërinstitucional dhe ndërkombëtar kundër trafikimit të personave.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm u referohen termave pjesë të Konventave Ndërkombëtare me fushë veprimi mbi trafikimin e personave dhe pjesë e legjislacionit shqiptar, duke pasur kuptimin:

a) “Trafikimi i qenieve njerëzore”² nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që

¹ Shih nenin 28, pikë 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar ndërkombëtar “*Çdo Shtet Palë duhet të marrë në konsideratë monitorimin e politikave dhe të masave të tij aktuale në luftën kundër krimtit të organizuar dhe të bëjë vlerësimet për efektshmërinë dhe rendimentin e tyre*”; shih nenin 9 të Protokollit të Palermos: “*Shtetet Palë duhet të vendosin politika, programe dhe masa të tjera: (a) për të parandaluar dhe luftuar trafikun e personave; dhe (b) për të mbrojtur personat e trafikuar, veçanërisht gratë dhe fëmijët, nga riviktimizimi*”.

² Shih nenin 4 të Konventës së Këshillit të Europës “*Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore*” (Konventa e Varshavës); shih nenin 3 të Protokollit Shtesë të Palermos “*Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave e të fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar ndërkombëtar*”, i cili përdor terminologjinë “*trafikim i personave*” duke bërë një përcaktim të plotë detyrues të trafikimit si bazë për legjislacionet e brendshme.

kanë një pozicion të pambrojtur, apo dhënien ose marrjen të pagesave apo përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi, brenda³ ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shfrytëzimi duhet të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, ose heqjen e organeve;

b) Pëlqimi⁴ i një viktime të “trafikimit të qenieve njerëzore” në lidhje me shfrytëzimin e synuar, të parashtruar në nënparagrafin (a) të këtij neni, nuk do të jetë i vlefshëm kur është përdorur ndonjë nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a);

c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi, do të konsiderohet “trafikim i qenieve njerëzore” edhe nëse kjo nuk përfshin një nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a) të këtij neni.⁵

d) “Fëmijë/i mitur”⁶ do të nënkuptojë çdo person nën moshën 18 vjeç që është objekt trafikimi qeniesh njerëzore, siç përcaktohet në pikën (1) të këtij neni. Kur mosha e viktimës nuk dihet dhe ka arsyë të besohet që viktima është fëmijë/i mitur, ai ose ajo do të prezumohet⁷ të jetë një fëmijë/i mitur dhe do t'i sigurohen masa të posaçme mbrojtëse, në pritje të verifikimit të moshës së tij/saj.

e) “Viktimë”⁸ do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në pikën (1) të këtij neni.

f) “Pozitë e vulnerabilitetit”⁹ i referohet situatës ku personi i përfshirë nuk ka asnë alternativë tjetër konkrete ose të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet abuzimit ku është përfshirë.

³ Shih vendimin njehsues nr.00-2022- 1679 (217), datë 15.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë: “Trafikimi i qenieve njerëzore nuk kërkon domosdoshmërisht kalimin e kufijve shtetërorë dhe nuk ka vetëm natyrë transnacionale. Trafikimi i qenieve njerëzore ka si qëllim kryesor shfrytëzimin e viktimës. Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit të shtetit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe forma të tjera të shfrytëzimit, të realizuara nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës, etj. Kolegji thekson se në këtë rast nuk gjen zbatim parimi i territorit.”.

⁴ Terminologjia është përshtatur.

⁵ Shih po aty: “Së pari, në rastin e trafikimit të një të mituri, mjetet e përdorura (që janë kërcënimi, përdorimi i forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimi, marrja me forcë, dredhi apo abuzimi me pushtetin ose pozitën vulnerabël, dhënia apo marrja e pagesave ose përfitimeve) për të arritur qëllimin kriminal nuk kanë rëndësi, pra nuk ndikojnë në cilësimin juridik të kësaj vepre penale. E thënë ndryshe, për cilësimin juridik të faktit penal, mjafton të provohet ekzistенca e njërsës prej formave të trafikimit (që janë rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturit), si dhe qëllimi për shfrytëzimin e tij. Së dyti, vullneti apo pëlqimi i të miturit viktimë e trafikimit, në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk ka asnë vlerë, pavarësisht rrethanave apo mënyrës në të cilin ai është shfaqur.”

⁶ Shih nenin 4, shkronja “d” të Konventës së Varshavës; shih nenin 3 shkronja “d” të Protokollit të Palermos; shih nenin 3 shkronja “a” të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual”, miratuar me ligjin nr.10071/2009.

⁷ Shih nenin 10, pika 3 e Konventës së Varshavës.

⁸ Shih nenin 4, shkronja “e” të Konventës së Varshavës.

⁹ Shih nenin 3, shkronja “a”, nënprografi 63 i Raportit të Komitetit Ad-Hoc të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Elaborimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimít të Organizuar Ndërkombëtar.

2. “Trafikimi i personave”, nëse nuk është parashikuar ndryshe i referohet trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve.

Neni 4

Parimet e Konventave Ndërkombëtare për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të personave

1. Veprimtaria e policisë gjyqësore dhe prokurorit, në hetimin, ndjekjen penale dhe kërkesat për dënimë në çështjet e trafikimit të personave, duhet të udhëhiqet nga parimet e:
 - a) respektimit të dinjitetit, të të drejtave, lirive të njeriut dhe të procesit të rregullt ligjor¹⁰;
 - b) barazisë gjinore¹¹ dhe mosdiskriminimit¹², pa diskriminuar për arsyen tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina kombëtare apo sociale, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose një status tjetër;
 - c) sigurisë që procedimet penale të trajtohen si përparësi dhe të kryhen pa asnjë vonesë të pajustifikuar¹³;
 - d) mbrojtjes së viktimate të trafikimit, veçanërisht të grave dhe fëmijëve nga rivictimizimi¹⁴.
 - e) identifikimin, zbulimin, bllokimin e të ardhurave dhe pasurive nga krimi me qëllim konfiskimin¹⁵ e mundshëm si dhe sigurimin e mundësisë së kompèsimit dhe zhëmtimit të viktimate;
 - f) mbrojtjen e jetës private dhe identitetit¹⁶ të viktimate të trafikimit, në mënyrë të veçantë që identiteti ose detajet që lejojnë identifikimin e një fëmije viktimë të trafikimit, të mos bëhen publike nëpërmjet medias ose çdo mjeti tjetër, përvëçse në rrithana të jashtëzakonshme, me qëllim që të lehtësojë gjurmimin e anëtarëve të familjes ose të sigurojë mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës;
 - g) hetimin e korruptionit të zyrtarëve publikë¹⁷, që në ushtrim të detyrave të tyre kanë vepruar apo mosvepruar për kryerjen e trafikimit të personave, apo në rastet e marrjes pjesë si bashkëpunëtor; dhe
 - h) dënimin e personave fizikë dhe juridikë të përfshirë në trafikimin e personave me sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse¹⁸.

KREU II

¹⁰ Shih Konventën Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137/2016.

¹¹ Shih nenin 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe nenin 17 të Konventës së Varshavës.

¹² Shih po aty nenin 3 mbi përkufizimin e “Parimit të mosdiskriminimit”.

¹³ Shih nenin 30 pika 3 e Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual”.

¹⁴ Shih nenin 9, pika 1 shkronja “b” e Protokollit të Palermos.

¹⁵ Shih nenin 12 pika 2 dhe nenin 25 pika 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar ndërkombëtar; shih nenin 23 pika 3 të Konventës së Varshavës.

¹⁶ Shih nenin 6, pika 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar ndërkombëtar; shih nenin 11 të Konventës së Varshavës.

¹⁷ Shih nenet 8, 9 dhe 11 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar ndërkombëtar; shih nenin 24, shkronja “c” të Konventës së Varshavës.

¹⁸ Shih nenin 23 të Konventës së Varshavës.

MASAT PROCEDURALE NË HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE TË VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE¹⁹

Neni 5

Masat procedurale të drejtuesit të prokurorisë

Drejtuesit e prokurorive, në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligj²⁰, vlerësojnë nevojat për marrjen e masave procedurale në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale të trafikimit të personave, në përshtatje me gjendjen e treguesve të kriminalitetit dhe problematikat e evidentuara në rrithin/et gjyqësore²¹ që mbulon prokuroria që drejtojnë, si dhe për të lehtesar²² dhe garantuar²³ zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me masat procedurale, duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve, marrin masat si më poshtë:

- a) kërkojnë informacion dhe verifikojnë ecurinë/përfundimin e procedimeve në hetimet paraprake ose në gjykim, për veprat penale prioritare të rekomanduara të trafikimit të personave, duke monitoruar në veçanti, respektimin e afateve procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve, respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal, garantimin e procesit të rregullt ligor, duke garantuar paanshmërinë dhe shhangjen e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj prokurorit;
- b) nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete të trafikimit të personave, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshirë dhe rastet e regjistruar/filluara kryesish me iniciativën e tyre apo të prokurorëve, si edhe kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit gjatë hetimeve paraprake ose në fazën e gjykimit;
- c) në vlerësimin e këtyre çështjeve, drejtuesit duhet të jenë të vëmendshëm të bëjnë dhe një analizë të drejtë të rrethanave të faktit dhe të cilësimit ligor të veprës penale në rastet kur ka dyshime të bazuara se ka elementë të veprave penale të trafikimit të personave, pavarësisht se materialet e referuara nga policia gjyqësore apo të regjistruar nga prokurori, janë për vepra penale të ndryshme nga trafikimi. Në këto raste, drejtuesit nxjerrin udhëzim jo të detyrueshëm me sugjerime dhe detyra konkrete për prokurorin e çështjes, duke monitoruar në vazhdimësi ecurinë e saj në hetim dhe në gjykim;
- c) në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit duke e urdhëruar²⁴ të kryejë veprime hetimore më të thelluara në drejtim të hetimit të veprave penale të trafikimit të personave

¹⁹ Shih udhëzimin e përgjithshëm nr.5/2018, mbi udhëzimet që duhet të ndiqen nga prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokurorisë gjatë ndërveprimit të tyre me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale.

²⁰ Shih nenet 42, 43, 46, pikat 1, 3, shkronja "c", dhe nenet 48, 49, 52 e vijues të ligjit nr. 97/2016.

²¹ Rrethi gjyqësor në kompetencë tokësore të gjykatës së shkallës së parë e juridiksonit të përgjithshëm pranë të cilës ushtron funksionet prokuroria e rrëthit gjyqësor dhe rrëthet gjyqësore në kompetencë tokësore të gjykatës së apelit me juridikson të përgjithshëm pranë të cilës ushtron funksionet Prokuroria e apelit.

²² Shih nenin 46, pika 4 e ligjit nr. 97/2016.

²³ Shih po aty nenin 43, shkronja "dh".

²⁴ Shih nenin 329, pika 3, shkronja "b" të Kodit të Procedurës Penale.

të rritur dhe/apo të të miturve; apo duke e urdhëruar²⁵ të formulojë akuzë, drejtuesi i kërkon informacion prokurorit për shkaqet dhe ecurinë e mëtejshme të hetimit;

d) të nxjerrin urdhra për policinë gjyqësore që kanë në juridikcion lidhur me ushtrimin e funksioneve në kuadër të luftës kundër trafikimit të personave, si dhe për vepra të tjera që lidhen me trafikimin, siç janë veprat penale në fushën e pastrimit të parave dhe hetimet pasurore;

dh) të mbështesin punën e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet menaxhimit të duhur të burimeve njerëzore dhe logistike në dispozicion, si dhe për ristrukturimin apo përditësimin e standardeve të ambienteve të posaçme, të përshtatshme, të sigurta në prokurori dhe të aksesueshme për viktimat e trafikimit;

e) të zhvillojnë mbledhje tematike me prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve të trafikimit të personave dhe me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve apo të shërbimeve në policinë e shtetit të ngarkuar në hetimin e veprave penale të trafikimit të personave;

ë) të diskutojnë rregullisht problematikat, praktikat hetimore dhe gjyqësore lidhur me caktimin e masave të sigurimit dhe masave të dënimit ndaj trafikantëve të personave, me qëllim unifikimin e masave procedurale dhe politikës penale ndëshkuese ndaj trafikantëve dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit;

f) të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me institucionet shtetërore ligjzbatusse me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale të trafikimit të personave, si dhe të organizojnë dhe zhvillojnë analiza të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave;

2. Masat procedurale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, janë të detyrueshme dhe të zbatueshme brenda kompetencave të parashikuara në ligj²⁶ edhe për drejtuesit e seksioneve që kanë në kompetencë hetimin e veprave penale të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve.

Neni 6

Masat procedurale të prokurorit

Prokurorët vlerësojnë në çdo rast udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose udhëzimet e nxjerra nga drejtuesi i prokurorisë në zbatim të tyre, në drejtim të luftës ndaj trafikimit të personave në kompetencë lëndore të tyre, për të garantuar zbatimin e tyre nëpërmjet masave procedurale të udhëzuara, si më poshtë:

a) të jenë aktiv gjatë hetimeve paraprake sipas ligjit, në marrjen dijeni për vepra penale nga burime të hapura me iniciativën e vet, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale trafikimit të paligjshëm të personave;

b) prokurori informon drejtuesin e prokurorisë, sipas kërkesës së tij, mbi ecurinë dhe problemet e veprimeve të para hetimore në rastet e ngjarjeve të ndodhura gjatë kryerjes së gatishmërisë dhe/ose mbi ecurinë e procedimi penal, përpara përfundimit të tij;

c) kryejnë hetime të plota e të gjithanshme për veprat penale dhe/ose ndaj subjekteve të trafikimit të personave, sipas kompetencës lëndore, në bashkërendim me Prokurorinë e

²⁵ Shih nenin 329, pika 3, shkronja "c" të Kodit të Procedurës Penale.

²⁶ Shih nenin 21, paragrafi 1, të ligjit nr.97/2016.

Posaçme sipas ligjit dhe aktit të koordinimit ndërinstitucional²⁷, duke rritur më tej treguesit/rastet e hetimeve proaktive efektive, përdorimin e metodave speciale të hetimit sipas ligjit, hetimet financiare paralele apo hetimet pasurore, si dhe për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve produkte të veprave penale ose veprimtarive kriminale të trafikantëve;

ç) vlerësojnë me kujdes ekzistencën e kushteve/kritereve ligjore për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale, duke synuar vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale, me synim për të parandaluar dhe riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale të trafikimit të qënieve njerëzore;

d) kryejnë analiza të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve në policinë e shtetit dhe/ose të agjencive ligjzbatuuese kombëtare dhe ndërkombëtare, për rastet e referuara dhe ato në hetim, në funksion të kryerjes së hetimeve të specializuara dhe të shpejta ndaj trafikimit të personave;

dh) tregojnë kujdes të shtuar në ruajtjen e sekretit të hetimit dhe ndalimin e publikimit të akteve;

e) garantojnë trajtimin me respekt të dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen nga viktinizimi i përsëritur²⁸ dhe viktinizimi i dytë²⁹ të viktimateve të veprave penale gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre në proces.

ë) gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit, prokurori të vlerësojë me përparësi mbajtjen e një qëndrimi mbështetës në përputhje dhe me faktet e çështjes ndaj padisë civile të viktimateve të trafikimit në procesin penal për shpërblimin e dëmit, duke e vlerësuar sipas rastit me detyrimin ligjor për moscënimin e afateve të paraburgimit të të arrestuarve të trafikimit të personave.

f) prokurori në momentin e regjistrimit të veprave penale të trafikimit të personave me elementë ndërkombëtar, si dhe gjatë ecurisë së hetimit, duhet të vlerësojë nevojën për përdorimin e instrumentave ndërkombëtare të bashkëpunimit, duke koordinuar me Drejtorinë për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, Eurojust³⁰ dhe projekteve³¹ të tij, me qëllim hetimin e shpejtë, bashkërendues dhe efektiv të këtyre çështjeve.

Neni 7

²⁷ Shih Aktin e Koordinimit Ndërinstitucional, datë 15 dhjetor 2020, mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

²⁸ Shih pika 1 e Rekomandimit të vitit 2023 të Komitetit të Ministrave në Këshillin e Europës “*Mbi ndihmën ndaj viktimateve të krimít për shtetet anëtare mbi të drejtat, shërbimet dhe ndihmën ndaj viktimateve të krimít*” jep përkufizimin: “*Viktinizim i përsëritur*” nënkuption një situatë në të cilën i njëjtë person është viktimë e më shumë se një vepre penale gjatë një periudhe kohe të caktuar dhe përfshin, në veçanti, situata e një cilës personi është viktimë e veprave penale të shkaktuara nga i njëjtë shkelës dhe situatave e një cilat një person është viktimë e veprave penale të së njëjtës natyrë të shkaktuara nga shkelës të ndryshëm”.

²⁹ Shih po aty, pika 1, paragrafi 4 jep përkufizimin: “*Viktinizimi i dytë*”²⁹ është viktinizimi që ndodh jo si pasojë direkte e veprës penale por si pasojë e veprimeve të institucioneve publike dhe private dhe individëve të tjerë ndaj viktimitës”.

³⁰ Shih Marrëveshjen për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, miratuar me Ligjin nr.113/2018.

³¹ Projektin aktual të Drejtësisë Kriminale në Ballkanin Perëndimor mbështetur nga Eurojust.

Informimi i drejtuesve të prokurorisë

1. Në momentin e nxjerrjes së urdhrit për ndryshimin³² e cilësimit ligjor të veprës, prokurori duhet të dorëzojë menjëherë në zyrën e regjistrat një kopje të këtij urdhri.

2. Zyra e regjistrat në prokurori njofton menjëherë drejtuesin për çdo urdhër të prokurorit për ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale që kanë të bëjnë me veprat penale të trafikimit të personave të rritur dhe/apo të trafikimit të të miturve. Drejtuesi duhet t'i kërkojë menjëherë informacion prokurorit dhe nëse nuk e vlerëson të bazuar ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës, nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm për çështjen, dhe ndjek vijimësinë e zbatimit të tij.

Neni 8

Roli i koordinatorit të viktimate

Koordinatorët e viktimate pranë institucionit të prokurorisë, në bashkërendim me prokurorin dhe oficerin e policisë gjyqësore, jepin asistencën dhe ndihmën e kërkuar për viktimat e trafikimit, në përputhje me Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimate dhe dëshmitarëve të veprave penale”, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe përbushin detyrimet e prokurorisë për informacion, referimin e viktimate tek ofruesit e shërbimeve dhe garantimin e mundësive për ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre.

KREU III

MASA TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE³³ NË HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE TË VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE

Neni 9

Masat administrative të drejtuesit të prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm kur organizon strukturën e brendshme të prokurorisë, në varësi të problematikave procedurale dhe administrative të asaj prokurorie në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve, të ketë në vëmendje hetimin e këtyre veprave penale nga prokurorë të specializuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të viktimate të trafikimit, në veçanti të të miturve.

2. Në rastin e hetimit të çështjeve të trafikimit të personave të lidhura dhe me veprat penale në fushën e narkotikëve apo të krimeve të tjera të rënda, drejtuesi i prokurorisë në varësi të kompleksitetit të hetimit, vlerëson krijimin e grupit hetimor me prokurorë të sektioneve të ndryshme, me qëllim hetimin efektiv dhe të shpejtë të këtyre çështjeve.

³² Shih nenin 288, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale.

³³ Shih nenin 2, shkronja "d" të ligjit nr.97/2016.

3. Procesi i mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore për viktimat vulnerabël, kryhet në përpjekje me parashikimet e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.17/2020³⁴ "Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje" dhe mbikëqyret nga drejtuesi i prokurorisë ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 10

Masat në marrëdhënie me policinë gjyqësore

1. Prokurori ushtron sistematikisht kontroll efektiv ndaj oficerëve të policisë gjyqësore në ecurinë e hetimit të procedimeve në ndjekje për ligjshmërinë, objektivitetin, plotshmërinë dhe respektimin e afateve në veprimet hetimore të kryera dhe/ose vlefshmërinë e akteve procedurale të përfshuara.

2. Prokurori duhet të vlerësojë me kujdes çdo ankesë të paraqitur nga viktima, në lidhje me veprimtarinë e shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse.

3. Drejtuesi i prokurorisë dhe/ose prokurori i çështjes konkrete, në rast evidentimi të akteve dhe sjelljeve që përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit³⁵, kërkojnë fillimin e procedurës disiplinore sipas ligjit³⁶.

Neni 11

Trajnimet

1. Drejtuesit e prokurorisë nxisin dhe koordinojnë trajnime të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër trafikimit të personave, si dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime, ndër të tjera, mbi bazueshmërinë në ligj të hetimeve dhe vlefshmërinë e provave në hetimet penale, hetimet financiare dhe kimeve kibernetike, në teknikat e intervistimit, teknikat e strategjitë hetimore, arrestin dhe formulimin e akuzave, mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar viktima, përfshirë përfitimin financier nga shfrytëzimi i viktimës, si element i rëndësishëm për të mbështetur pretendimet e ardhshme për kompensim, etj.

2. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore duhet të trajnohen për vlerësimin dhe identifikimin e viktimave të krimít, në veçanti të viktimave të mundshme³⁷ të trafikimit dhe

³⁴ Shih neni 2 i Direktivës 2011/36/BE së Parlamentit European dhe Këshillit European "Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe zëvendësimin" në pikën 2 jep përkufizimin: "Viktima vulnerabël" përfshin, në veçanti, të paktën të gjithë fëmijët dhe kur një vepër kryhet të tilla rrethana, dënim i duhet të jetë më i ashpër. Faktorë i tjerë që duhet te merren në konsideratë kur vlerësohet vulnerabiliteti i një viktime përfshijnë, për shembull, gjininë, shtatzaninë, gjendjen shëndetësore dhe paafësitet"; shih nenin 7, pika 2 të vendimit kornizë të Këshillit të Europës 2002/629/JHA për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

³⁵ Shih nenin 33 "Shkeljet disiplinore" të ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", i ndryshuar.

³⁶ Shih po aty, nenin 35 "Subjektet që kanë të drejtën e fillimit të procedimit disiplinor".

³⁷ Shih referencën nr.25 në Publikimin e OSCE "Trafikimi i qenieve njerëzore: Identifikimi i viktimave të mundshme ose të prezumuara. Një qasje e politikës së Komunitetit", Vol.10, Vjenë, jep përkufizimin: "Viktimi e mundshme" përdoret për të treguar individët nga grupet vulnerabël që mund të bëhen viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, për të cilin përdoren dhe tërmat "persona të trafikuar" ose "viktima të trafikimit njerëzor".

viktimat e trafikimit të shfrytëzimit të prostitucionit, viktimat e dhunës seksuale, vlerësimin e nevojave bazuar në rrethanat e tyre specifike, pavarësisht nga kallëzimi i veprës penale.

KREU IV

POLITIKA PENALE³⁸

Neni 12

Politika penale në hetimin dhe gjykimin e veprave të trafikimit të personave

Me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër trafikimit të personave dhe parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të këtyre veprave, drejtuesit e prokurorisë dhe prokurorët gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative dhe procedurale zbatojnë një politikë penale të ndëshkimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke ndjekur dhe drejtimet e politikës penale të përcaktuara çdo vit në udhëzimet e përgjithshme/urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në funksion të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave përf Luftën ndaj kriminalitetit dhe rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

KREU V

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, SHFUQIZIME, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 13

Shkeljet dhe përgjegjësia disciplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë shkelje disciplinore sipas ligjit³⁹ dhe/ose shkak përf nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiktion të përgjithshëm, sipas ligjit.

Neni 14

³⁸ Shih Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës nr.19/2000 “Për rolin e prokurorit publik në sistemin e drejtësisë penale” tek pjesa “Komentet e Rekomandimeve Individuale”, nënpjesa “Funksionet e prokurorit publik, pika 3 parashikon: “Në disa sisteme të drejtësisë penale, prokurorët publikë, gjithashtu: -zbatojnë politikën penale kombëtare ndërsa e adoptojnë atë, aty ku është e përshtatshme, me rrethanat lokale dhe rajonale”, duke vijuar komenti: “Zbatimi i politikës kundër krimít siç përcaktohet nga autoriteti legjislativ ose ekzekutiv është një nga detyrat kryesore të prokurorit publik në shumë vende. Përshtatja e politikës kombëtare me realitetet rajonale dhe lokale nuk nënkupton lirinë e prokurorëve publikë përf t'u larguar nga prioritetet e përcaktuara në strategjinë qendrore ose përf t'ë rrezikuar zbatimin e saj të vazhdueshëm. Përkundrazi: përshtatja ndaj kushteve rajonale dhe lokale është një kusht paraprak nëse këto përparësi zbatohen siç duhet”.

³⁹ Shih nenin 101, pika 1, shkronjat "a", "b" dhe nenin 102, pika 1, shkronjat "d", "dh", "s", "j", dhe pika 2, shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh" e vijues të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019.

Zbatimi dhe mbikëqyrja

Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, drejtuesit e seksioneve, drejtuesit e prokurorive dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve dhe të seksioneve në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm.⁴⁰


Neni 15
Shfuqizime

Udhëzimi i përgjithshëm nr.02, datë 15.05.2003 “Mbi hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore” shfuqizohet.

Neni 16
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKURORLI PËRGJITHSHËM



⁴⁰ Shih, nenin 46, pikë 1 dhe nenin 103, të ligjit nr.97/2016.